# DËSHMI ARKIVI

**A-436968**
VERSIONI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Pse nuk po funksionon diplomacia e Jared Kushnerit dhe Steve Witkoffit dhe pse Marco Rubio po qëndr on larg tyre? |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/bota/pse-nuk-po-funksionon-diplomacia-e-jared-kushnerit-dhe-steve-witkoffit-dhe--i585430` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 14:17:49 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 15:00:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `888612ce0a6d09dd959c772a8d65d1118740f9fbd47a4fc893b82ad3af78f227` |
| TEKSTI | `7eadcdbe4d448ec99ed36012f572b16fc177f3f97ec2b23ad813914b36462803` |
| PAMJA | `f721692feeeae877a78bfd9ffa686f5b045f3d462e84795ec0d76732224f1945` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `ef81d66661881a32fb34793cd465e495b31d0904da197db77422baa7a83d04d5` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/ef81d66661881a32fb34793cd465e495b31d0904da197db77422baa7a83d04d5`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Pse nuk po funksionon diplomacia e Jared Kushnerit dhe Steve Witkoffit dhe pse Marco Rubio po qëndron larg tyre?

11 Shtator 2026, 17:00Bota TEMA

Pse nuk po funksionon diplomacia e Jared Kushnerit dhe Steve Witkoffit dhe pse

**Nga Enver Robelli**

“Financial Times” është gazetë e botës kapitaliste, askush s’mund ta akuzojë për majtizëm. Përkundrazi: kjo e përditshme britanike me rëndësi globale mbron vlerat perëndimore.

Në një analizë të komentatorit Edward Luce tregohet se përse po dështon angazhimi diplomatik i Jared Kushnerit dhe Steve Witkoffit? Sepse, sipas Luce, Kushner dhe Witkoff po përpiqen të zgjidhin konflikte gjeopolitike përmes logjikës së biznesit dhe pasurive të paluajtshme.

Ndërsa sekretari i Shtetit Marco Rubio i shmanget këtyre përpjekjeve sepse e kupton pafuqinë e tyre, Kushner dhe Witkoff e përdorin premtimin e fitimeve financiare si mjetin kryesor të presionit. Rubio është edhe këshilltar për siguri nacionale i presidentit amerikan, pra që nga koha e Henry Kissingerit asnjë politikan amerikan nuk i ka mbajtur këto dy funksione. Megjithatë, Rubio po qëndron larg nga diplomacia e Kushnerit dhe Witkoffit.

Qasja biznesoro-diplomatike e tyre ka dështuar në Ukrainë, ku ata injoruan synimet territoriale të Vlladimir Putinit dhe nevojën ekzistenciale të Ukrainës për mbrojtje. Të njëjtat gabime dhe mosprania e ekspertëve ndikuan në dështimin e bisedimeve bërthamore me Iranin, si dhe propozimet e papërgjegjshme të Kushnerit për zhvendosjen e popullsisë së Gazës me qëllim rindërtimin e saj për projekte tregtare buzë detit.

Në pjesën e fundit, artikulli i “Financial Times” ndalet veçanërisht te Shqipëria, ku pasojat e kësaj diplomacie janë mjaft të dukshme. Kushner planifikon një projekt kontravers për ndërtimin e deri në 10’000 vilave luksoze në një zonë të mbrojtur ekologjike në bregdetin shqiptar. Kjo marrëveshje e ka çuar vendin në prag të një revolucioni politik, ku protestuesit e shumtë kanë adoptuar flamingon – shpendin e rrezikuar që jeton në atë trevë bregdetare – si simbolin kryesor të rezistencës.

Kryeministri Edi Rama ndodhet nën një presion të jashtëzakonshëm nga këto protesta popullore. “Shqipëria nuk është në shitje”, thonë protestuesit shqiptarë, që zakonisht janë proamerikanë. Nëse të dërguarit e Trumpit do të dëgjonin, pjesë të tjera të botës po përpiqen t’u thonë të njëjtën gjë, nënvizon gazeta “Financial Times”. Dëshira e dërguarve të Trumpit për të kthyer tokat publike në pronë private po përballet me një reagim të ashpër qytetar.

---


## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Huthit marrin kontrollin e pikave strategjike në Detin e Kuq, alarm për tregtinë globale

16:00 Bota

Merz i cilësoi politikat e tyre ndaj emigrantëve si "spastrim etnik," AFD kallëzim penal kundër Kancelarit

15:30 Bota

Tensionet në rajon, diskutime mes Arabisë Saudite dhe Iranit

15:20 Bota

11 shtatori i përgjakshëm i Kilit: si erdhi Pinocheti në pushtet dhe kush e vrau Allenden?

14:50 Bota / 2 komente

Rriten tensionet për Ishujt Falkland, presidenti i Argjentinës anulon vizitën në Mbretërinë e Bashkuar!

14:10 Bota / 2 komente

Sulm kibernetik në Berlin - "Masakër" të dhënash, 1.4 milionë përfundojnë në 'Darknet'

13:40 Bota

Republikanët mbyllin Konventën, Vance kandidat në 2028-ën?

12:10 Bota / 6 komente

Zelensky konfirmon takimin me Trump në fund të shtatorit: Pas mbledhjes në Nju Jork mund të jem më i hapur për negociatat

10:05 Bota

Nga Al-Kaida te "ujqit e vetmuar" dhe IA: Si ndryshoi terrorizmi pas 11 Shtatorit?

09:55 Bota / 1 koment

Irani synon të kontrollojë kontaktet me të huajt, projektligji për "infiltrimin" nxjerr në pah përçarjet brenda establishmentit

09:35 Bota / 1 koment

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**"Berisha gënjeu demokratët" - Bejko: Nuk ka më të drejtën...**

09:45 Politika / 22 komente

**Plas në PD, Cim Peka sulmon Belind Këllicin: Ky idioti po...**

15:45 Politika / 30 komente

**EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej "aferën e armëve" m...**

15:30 Dossier / 13 komente

**Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...**

13:04 Politika / 51 komente

**'Kallëzim se po zbatoj ligjin', ministri Malaj publikon p...**

19:05 Politika / 77 komente

## Blog Tema

**Shteti i leshit dhe Republika e Prokurorëve dhe Gjyqtarëve**

13:50 Blog / 13 komente

**Ministrja që Rama po kërkon**

12:40 Blog / 13 komente

**Demokracia, jo më si vlerë lirie**

12:30 Blog / 6 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by

- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies

Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.